

ANËTARËT E KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË BANKËS SË SHQIPËRISË



Z. Gent Sejko, Kryetar



Zj. Natasha Ahmetaj, Anëtare



Z. Tonin Kola, Anëtar



Z. Ridvan Bode, Anëtar



Zj. Luljeta Minxhozi, Zëvendëskryetare



Zj. Suela Popa, Anëtare



Zj. Edlira Luçi, Anëtare



Zj. Violeta Staka, Anëtare



Z. Artan Hoxha, Anëtar

1. KËSHILLI MBIKËQYRËS I BANKËS SË SHQIPËRISË

Organi më i lartë vendimmarrës dhe mbikëqyrës i BSH-së është Këshilli Mbikëqyrës, përgjegjës për vendimmarrjen e politikës monetare dhe për miratimin e udhëzimeve për zbatimin e saj. Këshilli ka përgjegjësinë përfundimtare për të vendosur mbi strategjinë e BSH-së, emërimin e drejtuesve të departamenteve, miratimin e strukturës organizative, si dhe përmbushjen e detyrimeve në lidhje me administrimin e rrezikut dhe përputhshmërisë. Ai i ushtron kompetencat e tij në përputhje me dispozitat e ligjit organik dhe me procedurat e parashikuara në rregulloren për organizimin dhe funksionimin e këtij organi.

Përgjegjësitë në fushat e procesit të raportimit financiar dhe sistemit të kontrollit të brendshëm i janë deleguar Komitetit të Auditit.

Procesi i vendimmarrjes në BSH udhëhiqet nga parimet e ligjshmërisë, pavarësisë dhe transparencës.

Kryefjala e vitit 2020 ishte COVID-19. Shpallja e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në të gjithë vendin, për shkak të pandemisë, ndikoi ndjeshëm në veprimtarinë dhe në mënyrën e funksionimit të Këshillit.

Për të zbutur impaktin në ekonomi, Këshilli mori një sërë masash të mbikëqyrjes bankare dhe politikës monetare. Këto masa kanë luajtur rol të rëndësishëm në mbështetje të qytetarëve shqiptarë, përmes nxitjes së aksesit të individëve dhe bizneseve në kredi, reduktimit të rreziqeve të bankave dhe ndihmesës së bankave për t'i ofruar mbështetje me financim ekonomisë.

Për të adresuar problemet e likuiditetit për bizneset dhe individët, Këshilli pezulloi përkohësisht kërkesat për klasifikim dhe provigjionim të kredive. Kjo u mundësoi klientëve t'u kërkonin bankave shtyrjen e pagesave të kësteve të kredive, pa penalitet. Gjithashtu, Këshilli u lejoi bankave ristrukturimin e kredive brenda këtij viti, pa provigjionime shtesë dhe pa asnjë përkeqësim në statusin e huamarrësit. Hyrja në fuqi e masave më të rrepta për klasifikimin dhe provigjionimin e huave të riklasifikuara u shty me një vit. E njëjta gjë vlen edhe për ristrukturimin jashtëgjyqësor për huamarrësit me probleme, i cili do të jetë i mundur në vitin 2022.

Nga ana tjetër, Këshilli uli normën bazë të interesit në një minimum të ri historik prej 0.5%, duke reduktuar më tej kostot e huamarrjes për individët dhe bizneset,



për të nxitur konsumin dhe investimet. Për të forcuar kapacitetet e bankave për të absorbuar humbjet dhe për të mbështetur huadhënien ndaj familjeve dhe bizneseve, u pezullua shpërndarja e dividendit nga bankat, deri në fund të vitit.

Paralelisht me këto, në funksion të nxitjes së bankingut përmes internetit, gjë që redukton numrin e njerëzve që kërkojnë shërbime në degët e bankave, Këshilli shfuqizoi komisionet për transfertat e parave në lekë.

Këshilli i zhvilloi të 15 mbledhjet e parashikuara në planin vjetor të punës. Tetë prej këtyre mbledhjeve iu dedikuan politikës monetare, 4 stabilitetit financiar dhe mbikëqyrjes; ndërsa në 3 mbledhjet e tjera u trajtuan: (i) programi vjetor i Këshillit; (ii) raporti vjetor i BSH-së; dhe (iii) strategjia afatmesme, buxheti vjetor dhe ai afatmesëm.

Këshilli ka marrë informacion të rregullt mbi politikat e administrimit të institucionit dhe mbi mënyrat dhe procedurat e përdorimit të mjeteve financiare për realizimin e veprimtarisë operative të BSH-së. Në mënyrë periodike janë paraqitur: informacioni mbi pozicionin dhe rezultatin financiar të BSH-së; si dhe informacioni i Komitetit të Investimit për ecurinë e administrimit të rezervës valutore. Këshilli është informuar periodikisht mbi gjetjet dhe rekomandimet e auditimeve të Departamentit të Kontrollit, mbi efektivitetin dhe cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm, administrimit të rrezikut dhe drejtimit të BSH-së.

Situata e pandemisë imponoi marrjen e vendimeve nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik. Për këtë arsye, viti 2020 regjistroi një numër rekord vendimesh qarkulluese – 19 të tilla. Nga ana tjetër, respektimi i rregullave të distancimit social bëri që mbledhjet e Këshillit, duke filluar nga muaji gusht, të zhvillohen në mënyrë virtuale, përmes platformës Webex.


Në dhjetor, Kuvendi vendosi zgjedhjen e anëtares së re të Këshillit, zj. Violeta Staka, duke kompletuar përbërjen e tij me 9 anëtarë të zgjedhur dhe të emëruar nga ky institucion.

KËSHILLI SI ORGANI MË I LARTË VENDIMMARRËS I BANKËS SË SHQIPËRISË

Këshilli ka kompetencë miratimit e të gjithë vendimeve, rregulloreve dhe udhëzimeve me zbatim të përgjithshëm që nxirren nga BSH-ja.

Gjatë vitit 2020 janë miratuar 81 vendime, prej të cilëve, 60 ishin akte të miratuara për herë të parë dhe 21 ndryshime ose plotësime aktesh ekzistuese.

Aktet e mësipërme janë nxjerrë në përmbushje të detyrave të Këshillit, siç përcaktohen në Ligjin për BSH-në, si: (i) stabiliteti monetar; (ii) licencimi, rregullimi dhe mbikëqyrja e bankave dhe institucioneve të tjera financiare; dhe (iii) ofrimi i infrastrukturës financiare (emisioni i kartëmonedhës dhe monedhës; shlyerja



e pagesave; kleringu i pagesave dhe i titujve dhe mbikëqyrja e sistemeve të pagesave).

- **Drejtimi dhe organizimi i brendshëm**

Ligji organik e përcakton Këshillin si organ përgjegjës për: (i) miratimin e Statutit dhe rregulloreve të brendshme të BSH-së; (ii) përcaktimin e strukturës organizative; dhe (iii) miratimin e drejtuesve të departamenteve dhe përcaktimin e kushteve të punësimit në Bankë.

Në muajin nëntor, Këshilli miratoi Strategjinë Afatmesme të Zhvillimit të BSH-së për periudhën 2021-2023, duke ruajtur të pandryshuar misionin, vizionin dhe vlerat e saj. Ky dokument është një përditësim i strategjisë ekzistuese për vitet 2020-2022.

Në dhjetor, në përmbushje të përgjegjësive për organizimin e brendshëm, Këshilli miratoi disa ndryshime në strukturën organizative të BSH-së në saj të nevojave të disa departamenteve për përmbushjen e objektivave strategjike, përmirësimin e proceseve të punës, duke shtuar punonjës apo duke riklasifikuar pozicione ekzistuese.

- **Buxheti**

Ligji për BSH-në e ngarkon Këshillin me miratimin e buxhetit dhe politikave të administrimit dhe procedurave të përdorimit të mjeteve financiare për realizimin e veprimtarisë operative të institucionit.


Në nëntor u miratua buxheti vjetor 2021 dhe ai orientues afatmesëm 2021-2023. Buxheti u miratua në përputhje me objektivat e Strategjisë Afatmesme të Zhvillimit të BSH-së, si dhe në parashikimet e departamenteve në lidhje me të ardhurat dhe shpenzimet për periudhën afatmesme.

Buxheti i BSH-së për vitet 2021-2023 synon: (i) përmirësimin e mëtejshëm të kuadrit të politikës dhe të operacioneve monetare; (ii) zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve profesionale; (iii) furnizimin e ekonomisë me kartëmonedhë cilësore dhe përpunimin me kujdes të saj; (iv) përsosjen e komunikimit dhe transparencës me publikun; si dhe (v) përmirësimin e infrastrukturës teknologjike, asaj të sigurisë dhe të ambienteve ku ushtrohet aktiviteti i BSH-së.

Shpenzimet kapitale dhe projektet e përfshira në buxhet u miratuan paraprakisht në Komitetin e Shpenzimeve Kapitale.

KËSHILLI SI ORGANI MË I LARTË MBIKËQYRËS I BANKËS SË SHQIPËRISË

Këshilli është informuar rregullisht nga hallkat e kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm për sigurimin e respektimit korrekt të ligjit dhe akteve të tjera që rregullojnë veprimtarinë e përditshme të institucionit.



- **Kontrolli i brendshëm**

Kontrolli i brendshëm është një veprimtari e pavarur nga administrimi, që ofron vlerësim, raportim dhe siguri objektive, si dhe përfshin funksionet e përputhshmërisë, auditimit të brendshëm dhe administrimit të rrezikut.

1. Kontrolli mbi administrimin

Çdo muaj, Këshilli Mbikëqyrës merr informacion nga administratorët, lidhur me zhvillimet ekonomike, financiare dhe monetare, në përmbushje të detyrimeve ligjore.

Këshilli është informuar edhe mbi politikat e administrimit të institucionit dhe përdorimin e mjeteve financiare për realizimin e veprimtarisë operative të BSH-së. Sikurse është parashikuar në ligjin organik, Guvernatori përgjigjet përpara Këshillit për zbatimin e vendimeve të miratuara, si dhe për drejtimin, kontrollin dhe mbikëqyrjen mbi administrimin dhe operacionet e Bankës.

Inspektori i Përgjithshëm dhe Departamenti i Kontrollit kontrollojnë dhe i paraqesin Këshillit raporte e rekomandime për llogaritë dhe regjistrat, si dhe për procedurat buxhetore, kontabël dhe kontrollet e BSH-së.


2. Veprimtaria e Komitetit të Auditit

Në funksion të rritjes së eficiencës dhe thellimit në fusha specifike, funksionet e auditimit të brendshëm i janë deleguar Komitetit të Auditit, i cili ushtron detyrat e tij në mbështetje të përfundimit të linjave të kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm. Ky komitet është përgjegjës për: (i) procesin e raportimit financiar; (ii) sistemin e kontrollit të brendshëm; (iii) auditin e brendshëm dhe të jashtëm; si dhe (iv) përputhshmërinë me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Komiteti përbëhet nga 3 anëtarë: zj. Suela Popa (Kryetar), z. Ridvan Bode dhe zj. Edlira Luçi. Anëtarët zgjidhen për një periudhë trevjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë. Administratorët nuk mund të jenë anëtarë të komitetit.

Komiteti i Auditit u mbledh shtatë herë për të diskutuar çështje si: (i) plani vjetor i punës dhe angazhimet e auditimit të brendshëm për vitin; (ii) raportimi periodik i Inspektorit të Përgjithshëm mbi veprimtarinë e auditimit; (iii) pasqyrat financiare të Bankës dhe Fondit të Pensionit, letra për drejtimin dhe opinionin e auditorit të jashtëm; (iv) buxheti vjetor dhe orientues afatmesëm; si dhe (v) Kodin e Etikës, rekomandim i rezolutës së Kuvendit.

Këshilli miratoi disa ndryshime në rregulloren "Për funksionimin e Komitetit të Auditit", që synojnë përmirësimin e funksionimit të Komitetit, në linjë me standardet dhe praktikën më të mira ndërkombëtare e në përputhje me rregulloren e BQE-së.



Komiteti i Auditit ka informuar rregullisht Këshillin mbi veprimtarinë e tij dhe zbatimin e përgjegjësive të veta, përmes informacioneve të veçanta, të prezantuara në Këshill nga Kryetari dhe anëtarët.

3. *Auditimi i brendshëm*

Inspektori i Përgjithshëm dhe Departamenti i Kontrollit, në mënyrë periodike dhe të pavarur: (i) vlerësojnë llogaritë dhe regjistrat kontabël, procedurat e administrimit dhe operacionet e BSH-së, me qëllim sigurimin e zbatimit të ligjeve dhe të akteve nënligjore; dhe (ii) ofrojnë siguri të arsyeshme për efektivitetin e sistemit të kontrollit, administrimit të rrezikut dhe proceseve të drejtimit, në funksion të përmbushjes së objektivave institucionale.

Inspektori i Përgjithshëm ka raportuar rregullisht në Këshill për realizimin e planit vjetor të punës së Departamentit të Kontrollit dhe rezultatet e angazhimeve të auditimit. Plani mbështetet në standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm dhe në vlerësimin e përditësuar të rrezikut për funksionet e identifikuara në universin e rishikuar të auditimit.

4. *Vijueshmëria e veprimtarisë*

Në zbatim të Politikës për Menaxhimin e Vijueshmërisë së Veprimtarisë në BSH, Inspektori i Përgjithshëm ka informuar Këshillin Mbikëqyrës lidhur me masat e marra nga BSH-ja për përballimin e situatës së emergjencës së krijuar nga COVID-19. Informacionet kanë paraqitur ecurinë kronologjike të veprimeve të ndërmarra në nivel parandalues dhe evoluimin e tyre për të gjithë punonjësit dhe departamentet e BSH-së.

- ***Kontrolli i jashtëm***

Ligji organik parashikon që llogaritë dhe regjistrat e BSH-së mund të kontrollohen nga auditorë të jashtëm të institucioneve audituese të njohura në arenën ndërkombëtare që miratohen nga Këshilli. Auditori i jashtëm shpreh opinionin e tij nëse raportet e përgatitura nga BSH-ja paraqesin, në mënyrë të plotë dhe të drejtë, situatën financiare të institucionit, në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit të pranuarra gjerësisht.

Pasqyrat financiare të BSH-së auditohen për të ofruar siguri të arsyeshme se ato nuk kanë pasaktësi, si rezultat i gabimeve apo mashtrimit. Kjo i mundëson auditorit të jashtëm një rol kyç në ruajtjen e besimit të tregjeve financiare dhe publikut në raportimin financiar të Bankës.

Komiteti i Auditit shqyrton efektivitetin dhe përshtatshmërinë e funksionit të auditimit të jashtëm. Përpara dorëzimit të opinionit mbi pasqyrat financiare, Komiteti takohet me auditorin e jashtëm, pa praninë e administratorëve, takim në të cilin diskutohet ecuria e procesit të auditimit.



LLOGARIDHËNIA DHE TRANSPARENCA

Ligji organik i jep Këshillit kompetencën për të miratuar të gjithë raportet dhe rekomandimet që BSH-ja i paraqet Kuvendit ose Këshillit të Ministrave, si dhe të miratojë raportet vjetore dhe raportet financiare të institucionit. Pas miratimit nga Këshilli, raportet publikohen.

- **Miratimi i raportit vjetor**

Në muajin mars, Këshilli miratoi dhe dërgoi në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave raportin vjetor 2019, i cili përshkruan zhvillimet e përgjithshme makroekonomike në vend dhe veprimtarinë e institucionit gjatë vitit.

Pjesë përbërëse e raportit vjetor janë edhe pasqyrat financiare të kontrolluara dhe certifikuar nga auditori i jashtëm dhe opinionit i tij. Këto pasqyra janë audituar nga Ernst & Young – Ekspertë Kontabël të Autorizuar. Sipas opinionit të Ernst & Young, pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozicionit financiar të Bankës më 31 dhjetor 2019, të performancës së saj financiare dhe flukseve të saj të parasë për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Në përputhje me përcaktimet e Manualit të monitorimit vjetor dhe periodik të institucioneve të pavarura kushtetuese, raportit iu bashkëlidh dhe informacioni mbi zbatimin e kërkesave të Kuvendit për raportimin vjetor të BSH-së.

- **Raportime të tjera për Kuvendin dhe Këshillin e Ministrave**

Sipas ligjit organik, BSH-ja publikon: (i) çdo tre muaj, një opinion të detajuar mbi gjendjen e ekonomisë, dhe (ii) çdo gjashtë muaj, një deklaratë për kërcënimet mbi stabilitetin e sistemit financiar.

Këshilli ka përmbushur rregullisht detyrimet e llogaridhënies së BSH-së ndaj Kuvendit dhe detyrimet e transparencës ndaj publikut, sistemit financiar dhe mediave, përmes përgatitjes dhe publikimit të raporteve tre dhe gjashtëmujore.

Mbi këtë bazë, në muajt shkurt, maj, gusht dhe nëntor, Këshilli ka miratuar raportet tremujore të politikës monetare që përbëjnë instrumentin kryesor të llogaridhënies dhe transparencës në fushën e politikës monetare. Këto raporte paraqesin një tablo gjithëpërfshirëse të zhvillimeve të fundit makroekonomike dhe faktorëve që ndikojnë në ecurinë e çmimeve të konsumit në vend.

Në muajt prill dhe në shtator janë miratuar raportet gjashtëmujorë të stabilitetit financiar, të cilët paraqesin vlerësimet e BSH-së për zhvillimet e sistemit financiar shqiptar, theksojnë rreziqet potenciale ndaj stabilitetit financiar dhe japin rekomandime në lidhje me masat e nevojshme për të reduktuar rreziqet. Raportet i janë dërguar Kuvendit, Këshillit të Ministrave dhe institucioneve të tjera qendrore.



- **Shpërndarja e fitimit**

Në mars, Këshilli miratoi shpërndarjen e fitimit të BSH-së për vitin 2019. Fitimi neto i realizuar gjatë vitit 2019 ishte në vlerën 1,345,785,333 lekë. Ky fitim rezulton të jetë rreth 158% më i lartë në krahasim me fitimin neto të realizuar nga BSH-ja në fund të vitit 2018. Përsa kryesore në këtë rritje i atribuohet të ardhurave nga shitjet e titujve. Fitimi neto llogaritet si rezultat i diferencës së të ardhurave neto nga aktiviteti i BSH-së (1,338,914,278 lekë) dhe shpenzimeve neto të provigjionimit (6,871,055 lekë).

Shpërndarja e fitimit miratohet me një vendim të ndarë nga ai i miratimit të pasqyrave financiare, të cilat pasqyrojnë vlerën e fitimit për t'u shpërndarë. Vlera e fitimit vendoset paraprakisht, në përputhje me ligjin organik që parashikon të gjitha zbritjet e mundshme, objekt miratimi nga Këshilli, përpara shpërndarjes.

